



UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

VENDIM

Nr.17, datë 20.07.2017

“Mbi pranimet dhe regjistrimet e studentëve në Universitetin e Tiranës për vitin akademik 2017-2018”

Bazuar në ligjin nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSH” neni 3, neni 25 dhe neni 38; Statutin e Universitetit të Tiranës neni 19 dhe neni 20; Senati Akademik i Universitetit të Tiranës, në mbledhjen e datës 20.07.2017;

VENDOSI:

1. Procedurat e regjistrimit për vitin akademik 2017-2018, do të kryhen sipas Udhëzimit nr. 15 datë 19.05.2017 të Ministrisë të Arsimit dhe Sportit “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në Institucionet e Arsimit të Lartë për vitin akademik 2017-2018”.
2. Përzgjedhja e studentëve fitues nga Departamenti dhe miratimi nga drejtuesi i njësive kryesore, do të bëhet sipas procedurave të përcaktuara nga Fakultetet.
3. Projekt-rregullorja “Për procedurat e pranimit dhe regjistrimit të studentëve në Universitetin e Tiranës” do të merret në shqyrtim në vitin e ardhshëm akademik.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

PROF. DR. MYNYR KONI